



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.07.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti** me nr. AKK-03-1768/14, për **z. Refet Kalisi**, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik në Komunën Hani i Elezit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

**II. Rasti mund të rihapet** në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Refet Kalisi – Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik në Komunën Hani i Elezit. dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Kalisi është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë është informuar për gjendjen në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të parandaluar gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Kalisi ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të hequr dorë nga pozita menagjuese – person i autorizuar në biznesin privat, në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-2748/14), në të cilën vërtetohet se i njëjti është larguar nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat Fabrika e Stiropollit Kosovaplast – Sh.P.K për të ushtruar funksionin e tij publik si Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

